



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
19.12.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit; Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së; Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së; Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së; Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së; Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së; Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së; Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së dhe Cuneyd Ustaibo, shef i subjektit politik KDTP.

Morën pjesë edhe: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë;
2. Propozimi i planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015;
3. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
4. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave;
5. Propozimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre;
6. Propozimrregullorja për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore;
7. Propozimrregullorja për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm;
8. Të ndryshme.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, kryesuesi, **Halim Halimi**, tha se tani kemi edhe një propozimvendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e një trafoje në

fshatin Drenoc. Ai kërkoi që pikat shtesë që paraqiten, të mos futen në rend dite nëse nuk kanë kaluar në Këshillin e Drejtorëve. Dy pikat e rendit të ditës: Propozimrregullorja për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore dhe Propozimrregullorja për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm, kanë kaluar në Komitetin për urbanizëm dhe planifikim.

Sami Hamiti, sa i përket Propozimrregullores për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore dhe Propozimrregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm, tha se nuk mund të ketë arsytim për moskalim në Komitetin për planifikim dhe urbanizëm, sepse komitetet janë trupa ndihmëse të Kuvendit.

Sa i përket pikës shtesë - Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e një trafoje në fshatin Drenoc, tha se mund të diskutohet.

Ylli Hoxha shprehu përkrahje lidhur me mendimin e parafolësit, që pikat e rendit të ditës të kalojnë nëpër komitetet përkatëse para se të dërgohen në Komitetin për Politik dhe Financa, në mënyrë që të funksionojnë këto komitete.

Agim Salihu sqaroi se lokacioni për vendosjen e një trafoje, ka kaluar në Këshillin e Drejtorëve, ndërsa çështja e trupave të komiteteve obligative dhe jo obligative, është e caktuar.

Lirak Çelaj përkrahu kalimin e këtyre tri pikave nëpër komitetet përkatëse profesionale, për shkak të cilësisë së dokumentit.

Islam Pacolli e përkrahi kalimin e këtyre pikave të rendit të ditës, por kërkoi që të bëhet praktikë që materialet të trajtohen nëpër komitetet përkatëse para se të dërgohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Dardan Sejdiu kërkoi sqarime nga shefi i zyrës Ligjore për punën e komiteteve.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Hatixhe Hoxha i përkrahi diskutimet e parafolësve, që materialet t'u dërgohen komiteteve përkatëse para se të përcillen në KPF.

Pas përfundimit të diskutimeve, **kryesuesi** tha se Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e një trafoje në fshatin Drenoc, të shkojë si pikë në Kuvend, ndërsa dy pikat: Propozimrregulloren për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore dhe Propozimrregulloren për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm, i hodhi në votim.

Kryesuesi konstatoi se me pesë (5) vota për, katër (4) kundër, u miratua dërgimi i këtyre pikave për Kuvend.

Pika e parë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015,

Kryesuesi informoi se grupi punues ka mbajtur dy takime.

Sami Hamiti tha se në parim ky është plan orientues, por mund të shtohen edhe pika të tjera, por si plan i plotëson kushtet.

Hatixhe Hoxha u shpreh në përkrahje të planit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah propozimi i planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Kryesuesi theksoi se në këtë propozimvendim është bërë zëvendësimi i përfaqësuesit të Drejtorisë së Arsimit, ku është emëruar Arbërie Nagavci, zëvendësimi i përfaqësuesit të OJQ-ve, ku është emëruare Shaban Kelmendi, dhe një përfaqësues nga Këshilli për Siguri Publike, ku është emëruar Florian Qehaja, ndërsa kryetari i Këshillit të prindërve caktohet pas emërimit.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Kryesuesi njoftoi se anëtarë të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave janë caktuar Lirie Avdiu nga Kuvendi i Komunës, dhe Hajrullah Çeku nga Shoqëria Civile.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hapjen e kutive të ankesave, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimin për lënien në diskutim publik të Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre, Agim Salihu dha sqarime, duke thënë se vërejtjet dhe sugjerimet do të inkorporohen në rregullore. Lirak Çelaj parashtrroi disa pyetje lidhur me këtë rregullore.

Pse është kufizuar rregullorja vetëm me qenë dhe mace? Duhet të bëhet rishikim i tërësishëm i kësaj rregulloreje. Duhet të jetë rregullore e veçantë se cilat kafshë mund të mbahen. Njëherësh pyeti se vendosja e çipave a është e obliguar, duke shprehur dilemë se në këtë punë dikush mund të bëjë biznes. Ai shprehu dilemë edhe në zbatimin e kësaj rregulloreje, duke thënë se në rast se nuk pëson ndryshime thelbësore, nuk do ta votojmë.

Islam Pacolli shprehu mendimin që të nxirret një rregullore internacionale, në mënyrë që të zgjidhet kjo çështje një herë e përgjithmonë. Kjo rregullore duhet të trajtohet seriozisht para se të dalë në diskutim publik.

Ylli Hoxha theksoi se kjo rregullore nuk është për t'u votuar, por për t'u dërguar në diskutim publik.

Agim Salihu sqaroi se nuk ka ligj të veçantë që përcakton këto kritere.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafosë në fshatin Drenoc, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Islam Pacolli theksoi se në seancën e fundit të Kuvendit u trajtua çështja e hapjes së kazinove në Hajvali , mirëpo nuk është bërë trajtimi si duhet, andaj banorët kërkojnë që në Kuvendin e Komunës të jetë prapë në diskutim çështja e bastoreve dhe kazinove.

Kryesuesi propozoi që kjo çështje të jetë në mbledhje të Kuvendit në pikën – Të ndryshme.

Imer Rusinovci tha se Kuvendi i Komunës ka 51 këshilltarë, andaj propozoj që, brenda mundësive, këshilltarëve të Kuvendit t’u sigurohet nga një “llap-top”.

Sami Hamiti tha se për këtë mund të bëhet kërkesë, dhe besoj se mund të realizohet kjo kërkesë.

Ylli Hoxha kërkoi që këshilltarëve t’u lihet në dispozicion një sallë e veçantë, me 5-6 kompjuterë, në shërbim të të gjitha grupeve parlamentare.

Kryesuesi premtoi se do ta trajtojë këtë çështje me ekzekutivin.

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

Procesmbajtës :
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur.i dipl.